



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 119/2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 87/2018 “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PARLAMENTAR “PËR NDJEKJEN DHE MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 12/2018 “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21/1 e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Grupit Parlamentar Demokrat,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 87/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën IV deputeti Arben Elezi caktohet Zëvendëskryetar.
2. Në pikën IV/1 deputeti Arlind Çaçani caktohet anëtar zëvendësues.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 9.10.2019